



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut (KMI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Regjistri i pasurive dhe vlerat e raportuara në Pasqyrat Financiare Vjetore ishin të nënvlerësuar për 8,338,135€ dhe të mbivlerësuar për 502,232€, si rezultat i mangësive në regjistrimin, klasifikimin dhe evidentimin e pasurive komunale.
- B2 Vendimet gjyqësore dhe përmbartimore në vlerë prej 3,150,927€ ishin ekzekutuar nga kategori ekonomike jo adekuate përmes Thesarit, duke rezultuar në keqklasifikim të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare Vjetore.
- B3 Vlera e detyrimeve kontingjente në PVF ishte mbivlerësuar për 228,130€.
- A1 Vlera e pajisjeve dhe mobilie e shpalosur në PFV nuk përputhet me vlerën e paraqitur në raportin e sistemit e-Pasuria, me një diferencë prej 877,578€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Mitrovicës së Jugut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Projekti “Ndërtimi i Çerdhes për Fëmijë në Shipol” nuk ishte përfunduar dhe funksionalizuar në kuadër të kontratës fillestare, duke rezultuar në realizimin e kontratave dhe ndërhyrjeve shtesë që rritën koston e projektit për 126,352€ apo 43%. Po ashtu, gjatë realizimit të projektit ishin evidentuar mospërputhje në paramasë, dhe punime të realizuara paralelisht përmes dy kontratave të ndryshme.
- A3 Komuna nuk kishte evidenca të plota mbi pronat e dhëna në shfrytëzim dhe nuk kishte monitoruar realizimin e obligimeve kontraktuale dhe arritjen e qëllimit për të cilin këto prona ishin dhënë në shfrytëzim.
- A4 Komuna në katër raste nuk kishte realizuar projektet brenda afateve kohore të përcaktuara me kontratë.
- A5 Për subvencionin e ndarë në vlerë prej 36,486€, komuna nuk kishte dëshmi të mjaftueshme se aktivitetet e projektit “Zhvillimi rural dhe agrobiznesi si promotorë të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm” ishin monitoruar dhe vlerësuar në përputhje me marrëveshjen.
- A6 Dy pajisje mjekësore për shërbime diagnostikuese, të blera dhe të pranuar në fund të vitit 2025 në vlerë prej 177,200€, nuk ishin funksionalizuar, ndërsa deri në periudhën e auditimit në terren (qershor 2026) komuna ende nuk kishte filluar krijimin e kushteve infrastrukturore të nevojshme për vënien e tyre në përdorim.
- B4 Komuna nuk kishte kryer verifikimin e të gjitha pronave brenda territorit të komunës.
- B5 Në nëntë pagesa me vlerë prej 143,667€ kemi vërejtur se faturat ishin vonuar për pagesë përtej afatit ligjor prej 30 ditësh.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Mitrovicës së Jugut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Mitrovicës së Jugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësimet ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 18 rekomandime, prej tyre 10 janë rekomandime të reja, shtatë të përsëritura dhe një pjesërisht e përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mbivlerësim/nënvlerësim i regjistrit të pasurisë në pasqyrat financiare vjetore (PFV)

Gjetja

Sipas nenit 11 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcaktohet se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim". "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisë të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi". Ndërsa, sipas nenit 10, përcaktohet se të gjitha pasuritë jo financiare pas pranimit në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore, pavarësisht se a janë paguar apo pjesërisht të paguara, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël dhe të jenë objekt i inventarizimit dhe vlerësimit.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se regjistri i pasurive ishte i nënvlerësuar për 8,338,135€ dhe i mbivlerësuar për 502,232€. Po ashtu, kemi identifikuar edhe raste të tjera të evidentimit jo të duhur të pasurive dhe investimeve në vijim, për të cilat për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe informatave të nevojshme nuk ishte e mundur të përcaktohej efekti financiar.

Mbivlerësimi i pasurive ka rezultuar nga rastet në vijim:

- Në regjistrin e pasurive të komunës ishin përfshirë 13 pasuri në vlerë neto prej 473,954€, të regjistruara gjatë periudhës 2009-2012, të cilat lidhen me rindërtimin e shtëpive në Kroin e Vitakut dhe me rindërtimin e shtëpive të djegura në veri të Mitrovicës, ndonëse sipas konfirmimit të ofruar nga komuna ato nuk ishin në pronësi të saj.
- Po ashtu, projektet "Rregullimi i shtratit të lumit Ibër", "Ndërtimi i Bibliotekës Latif Berisha" dhe "Rregullimi i objekteve shëndetësore QMF Bare dhe AMF Bajgorë" në vlerë totale 1,544,429€⁵ vazhdonin të figuronin si investime në vijim, ndonëse sipas dëshmimeve përkatëse projektet ishin përfunduar dhe vënë në përdorim. Si rezultat, për këto

projekte nuk ishte llogaritur zhvlerësimi në vlerë prej 28,278€. Ndërsa projekti “Ndërtimi i rrugës Suhodoll-Gushavc” në vlerë 31,777€ vazhdonte të figurojë si investim në vijim që nga viti 2015, mirëpo për shkak të mungesës së dokumentacionit mbi datën e pranimit apo vënies në përdorim, nuk ishte e mundur të vlerësohej ndikimi financiar.

- Tutje, nga analiza e regjistrit të pasurive kemi konstatuar se për projektet “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në qytet”, “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe stacionit të pompimit” dhe “Rregullimi i shtratit të lumit Ibër - bashkëfinancim me MMPH dhe Komunën e Mitrovicës”, me vlerë totale prej 1,650,792€, punimet e realizuara ishin regjistruar si pasuri në përdorim përmes 35 regjistrimeve të ndara gjatë periudhës 2020-2023, bazuar në situacionet e pranuar, e jo si projekte të përfunduara në tërësi. Për këto projekte zhvlerësimi i llogaritur ishte 253,876€.
- Vlen të ceket se nga vlera totale e investimeve në vijim prej 12,252,769€, kemi identifikuar se 3,083,748€ i përkasin projekteve dhe transaksioneve të periudhës 2015-2020, të cilat ende nuk janë mbyllur. Nga kjo vlerë, 647,861€ kanë të bëjnë me pagesa për hartimin e projekteve, të cilat nuk janë lidhur me projektet kapitale përkatëse dhe vazhdojnë të figurojnë si investime në vijim. Poashtu, për gjashtë pasuri me vlerë totale prej 14,772€, nuk ishte aplikuar zhvlerësimi, ndërsa ato vazhdonin të figuronin në regjistrin e pasurive që nga viti 2012 me vlerën e tyre fillestare.

Ndërsa, nënvlerësimi i pasurive ka rezultuar nga rastet në vijim:

- Projekti “Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Nexhat Çuni” ishte realizuar në bazë të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe OJQ-së “Shoqata Bamirëse Jetimat e Ballkanit”. Vlera totale e projektit, përfshirë edhe Aneks Marrëveshjen për rregullimin e oborrit, parkingut dhe instalimeve elektrike, ishte 6,016,852€. Nga kjo vlerë, OJQ-ja kishte financuar 4,752,929€, ndërsa Komuna e Mitrovicës 1,263,923€. Megjithëse objekti ishte pranuar teknikisht dhe ishte pajisur me Certifikatë të Përdorimit më 26.05.2025, në regjistrin e pasurive ishte evidentuar vetëm pjesa e financuar nga komuna, ndërsa nuk ishte evidentuar pjesa e financuar nga OJQ-ja në vlerë prej 4,752,929€. Si rezultat, pasuritë e komunës ishin të nënvlerësuara për 4,666,225€, pasi pjesa e financuar nga OJQ-ja nuk ishte regjistruar në kohë dhe nuk ishte reflektuar zhvlerësimi përkatës deri më 31.12.2025.
- Projekti “Ndërtimi i rrugës së pakategorizuar në pronën komunale Zona Selac 1, Selac 2 dhe Selac 3”, në vlerë prej 3,643,465€, ishte realizuar në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe SOWI Kosovo L.L.C. Edhe pse punimet ishin pranuar teknikisht më 22.09.2025, projekti nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurive. Si rezultat, pasuritë e komunës ishin të nënvlerësuara për 3,537,197€, duke përfshirë edhe efektin e zhvlerësimit deri më 31.12.2025.
- Komuna më datë 25.09.2025 kishte pranuar si donacion nga Ministria e Shëndetësisë, një autoambulancë në vlerë prej 74,790€. Megjithëse sipas marrëveshjes së dhurimit komuna obligohej ta regjistronte autoambulancën në listën e pasurive të saj, e njëjta nuk ishte regjistruar.
- Në dy raste, punimet e realizuara nga operatorët ekonomikë në vlerë prej 62,594€, për të cilat komuna kishte njohur obligime, nuk ishin

regjistruar në regjistrin e pasurive, ndonëse ato përfaqësonin investime të kryera deri më 31.12.2025.

Mangësitë e identifikuar kanë ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive, mungesës së koordinimit dhe shkëmbimit të dokumentacionit ndërmjet drejtorive përkatëse dhe zyrtarit të pasurive, si dhe mungesës së dokumentacionit të plotë për një numër projektsh. Gjithashtu, mungesa e certifikatave të pranimit të përkohshëm në disa raste ishte një nga shkaqet e mos transferimit të projekteve në pasuri në përdorim. Për më tepër, pasaktësi të trashëguara nga vitet e kaluara nuk janë rishikuar dhe adresuar në mënyrë sistematike.

Ndikimi Pasaktësitë e identifikuar ndikojnë që Pasqyrat Financiare Vjetore të mos pasqyrojnë në mënyrë të saktë dhe të plotë gjendjen e pasurive të komunës.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në menaxhimin e pasurive, në mënyrë që të gjitha pasuritë e përfituara, projektet e përfunduara dhe investimet kapitale të regjistrohen në kohë, me vlerën e plotë dhe në kategoritë përkatëse të pasurive. Po ashtu, duhet të sigurohet rishikimi periodik i investimeve në vijim me qëllim që Pasqyrat Financiare Vjetore të pasqyrojnë në mënyrë të saktë dhe të plotë gjendjen e pasurive të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013, shpenzimet duhet të regjistrohen në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2025 me vendime gjyqësore të ekzekutuara nga Thesari janë realizuar pagesa në vlerë prej 3,568,936€, prej të cilave 3,150,926€ janë ekzekutuar në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Për obligime që rrjedhin nga kontratat kolektive për paga jubilarë dhe shtesa janë paguar 2,441,273€ nga kategoria e investimeve kapitale dhe 217,120€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve;
- Përveç pagesave për paga dhe mëditje, nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar edhe 473,788€ për mallra dhe shërbime dhe 13,052€ për subvencione dhe transfere. Ndërsa, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë paguar 5,695€ për investime kapitale.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i dobësive në procesin e planifikimit buxhetor, si dhe vonesave në pagesën e obligimeve, veçanërisht atyre që rrjedhin nga kontratat kolektive.

Ndikimi Keqklasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësimin dhe nënvlerësimin e kategorive përkatëse, duke rezultuar në paraqitje jo të saktë të shpenzimeve në PFV. Po ashtu, përdorimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale për mbulimin e obligimeve të tjera mund të kufizojë

realizimin e projekteve kapitale të planifikuara.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël dhe natyrën e tyre ekonomike, me qëllim të paraqitjes së saktë të shpenzimeve në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontingjente në pasqyrat financiare vjetore

Gjetja

Sipas nenit 18 të Rregullores nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Gjatë auditimit të detyrimeve kontingjente të raportuara në PFV, kemi identifikuar pasaktësi në regjistrin e detyrimeve kontingjente si në vijim:

- Në dy raste, vlerat e lëndëve gjyqësore të përfshira në regjistër nuk ishin evidentuar saktë. Konkretisht, vlera e pretendimeve ishte 1,098€, ndërsa në regjistër dhe në PFV ishin raportuar 103,042€, duke rezultuar në mbivlerësim të detyrimeve kontingjente për 101,944€.
- Në një rast, vlera prej 71,016€ ishte përfshirë njëkohësisht në regjistrin e detyrimeve të papaguara dhe në regjistrin e detyrimeve kontingjente, duke rezultuar në raportim të dyfishtë dhe mbivlerësim të detyrimeve kontingjente për këtë vlerë.
- Tutje, nga testimet e kryera janë identifikuar 35 raste të lëndëve gjyqësore të regjistruara dy herë në regjistrin e detyrimeve kontingjente, duke rezultuar në mbivlerësim të detyrimeve kontingjente për 36,921€.
- Po ashtu, gjatë analizimit të regjistrit të detyrimeve kontingjente kemi identifikuar shtatë lëndë gjyqësore në vlerë prej 18,249€, të cilat ishin paguar gjatë vitit 2025, por nuk ishin larguar nga regjistri. Për më tepër, në të njëjtin regjistër ishin evidentuar edhe 270 raste të padive për paga jubilarë dhe shujta në vlerë prej 769,836€, të regjistruara që nga viti 2021 dhe më herët, për të cilat Zyra Ligjore nuk kishte siguri nëse ishin paguar apo jo.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosazhurnimit të rregullt të regjistrit të detyrimeve kontingjente, mungesës së koordinimit dhe shkëmbimit të informatave ndërmjet Zyrës Ligjore dhe Drejtorisë së Financave lidhur me statusin e lëndëve të ekzekutuara nga Thesari, si dhe gabimeve teknike gjatë regjistrimit dhe përditësimit të të dhënave në regjistër.

Ndikimi

Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon në cilësinë e informacionit financiar të shpalosur në PFV dhe mund të ndikojë që palët e interesit të mos informohen drejt lidhur me detyrimet e mundshme të komunës.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë koordinim më efektiv të informacionit ndërmjet Zyrës Ligjore dhe Drejtorisë së Financave, me qëllim që detyrimet kontingjente të evidentohen, përditësohen dhe vlerësohen në përputhje me dokumentacionin mbështetës, si dhe të prezantohen saktë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A1 - Mangësi në evidencën dhe raportimin e pasurive nën 1,000€****Gjetja**

Sipas nenit 2 të Rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare. Pasuria jo financiare e organizatës buxhetore përfshin pasurinë jo financiare kapitale, pasurinë jo financiare jo kapitale dhe stoqet, ndërsa nga aspekti i menaxhimit klasifikohet si pasuri që gjendet në depo dhe pasuri që është në përdorim. Po ashtu, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnojë regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të përfshijë pasuritë kapitale, pasuritë jo kapitale dhe stoqet, ku pasuria kapitale regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet regjistrohen në sistemin e-pasuria.

Gjatë auditimit kemi konstatuar se vlera e pajisjeve dhe mobilieve e raportuar në PFV ishte 1,545,760€, ndërsa sipas raportit të gjeneruar nga sistemi e-Pasuria ishte 668,182€, duke rezultuar në një diferencë prej 877,578€.

Veç kësaj, komuna nuk kishte dorëzuar raportin e pasurive sipas vlerës neto, por raportin e ngarkimit të mallrave për periudhën 2000-2025. Nga analizimi i këtij raporti kemi vërejtur se vlera prej 315,849€, ishte material shpenzues, i cili për nga natyra nuk i plotëson kriteret për t'u trajtuar si pasuri jo financiare.

Po ashtu, në bazë të një raporti të aseteve në depo të gjeneruar nga sistemi e-pasuria, janë paraqitur asete në vlerë prej 658,256€. Megjithatë, komuna nuk ka ofruar dëshmi mbështetëse dhe as sqarime lidhur me natyrën, statusin dhe trajtimin e këtyre aseteve.

Tutje, materiali mjekësor i sektorit të shëndetësisë në vlerë prej 39,552€, i përfshirë në vlerën totale të stokeve prej 324,337€ të prezantuara në PFV, mbahej në regjistra Excel dhe jo në sistemin e-pasuria.

Shkaku i kësaj ka qenë mungesa e një zyrtari përgjegjës për menaxhimin e sistemit e-pasuria dhe moskrijimi i qasjeve të nevojshme për përdoruesit relevantë për nxjerrjen e raporteve të plota dhe të besueshme nga sistemi.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave dhe raporteve të plota dhe të besueshme nga sistemi e-pasuria rrit rrezikun që pasuritë dhe stoqet të mos evidentohen, klasifikohen dhe raportohen saktë, duke ndikuar në cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë caktimin e një zyrtari përgjegjës për menaxhimin e pasurive në sistemin e-pasuria dhe krijimin e qasjeve dhe autorizimeve të nevojshme për zyrtarët relevantë, në mënyrë që të sigurohet evidencë e plotë dhe gjenerimi i raporteve të sakta për pasuritë dhe stoqet në përputhje me kërkesat e rregullores.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Rritje e kostos së projektit dhe përdorimi i kontratave shtesë për funksionalizimin e objektit

Gjetja

Sipas nenit 11.3 pika b të Rregullores për Prokurimin Publik, Zyrtari i Prokurimit, në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuuese, koordinon të gjitha dokumentet, projektet, specifikimet, Termat e Referencës (TeR), paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Gjithashtu, sipas nenit 19.3 të së njëjtës Rregullore, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë dhe përkufizojnë karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës dhe elementet tjera të nevojshme për realizimin e saj.

Për më tepër, sipas nenit 13.4 të Rregullores për Prokurimin Publik, një kontratë nuk mund të vazhdohet, të përtërihet ose të përcillet nga një kontratë pasuese pa administrimin e procedurës së re. Megjithatë, brenda një shume prej 10% të vlerës së kontratës një kontratë për furnizime/shërbime/punë shtesë, të cilat nuk ishin përfshirë dhe as kryer në kontratën origjinale, por të cilat për arsye të paparashikueshme janë bërë të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës, mund të realizohet si kontratë shtesë përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Kur një kontratë e tillë shtesë është relativisht e parashikueshme, vlera e tillë duhet të përfshihet në vlerën origjinale të parashikuar të kontratës. Ndërsa sipas nenit 70.23, menaxheri i kontratës duhet të sigurojë se Operatori Ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë.

Për projektin “Ndërtimi i Çerdhes për Fëmijë në Shipol”, komuna më 13.07.2020 kishte lidhur kontratë në vlerë prej 293,462€, me afat realizimi deri më 12.07.2021. Sipas kontratës, projekti përfshinte ndërtimin e objektit, punët përfundimtare dhe instalimet përkatëse me qëllim funksionalizimin e objektit. Për shkak të ndikimit të pandemisë, komuna kishte vazhduar afatin e realizimit deri më 12.07.2022. Deri në skadimin e këtij afati, ishin realizuar pagesa në vlerë totale prej 240,948€ ose 82% e vlerës së kontratës. Mirëpo edhe përkundër shtyrjes së afatit, projekti nuk ishte përfunduar.

Tutje, Më 06.09.2022, operatori ekonomik kishte paraqitur kërkesë për pagesë në vlerë prej 351,394€, duke pretenduar se gjatë realizimit të punimeve kishte kryer punë shtesë si rezultat i mangësive dhe mospërputhjeve në paramasën e projektit. Meqenëse komuna nuk e kishte pranuar kërkesën, operatori ekonomik kishte iniciuar procedurë përmbartimore. Pas kundërshtimit të urdhrit përmbartimor nga komuna, në tetor 2022 lënda ishte proceduar në gjykatë.

Megjithatë, për shkak se objekti kishte mbetur i papërfunduar dhe jashtë funksionit, komuna më 16.09.2024 kishte lidhur kontratë me titull “Ndërtimi i Çerdhes për Fëmijë në Shipol - Faza e Fundit” në vlerë prej 147,838€, me afat realizimi deri më 15.12.2024.

Edhe në rastin e kësaj kontrate, afati i realizimit ishte shtyrë deri më 10.04.2025, pasi punimet nuk kishin përfunduar brenda afatit të përcaktuar për shkak të kushteve të pafavorshme atmosferike dhe vështirësive gjatë realizimit të punimeve. Gjithashtu, gjatë realizimit të kontratës ishin identifikuar mospërputhje ndërmjet paramasës dhe gjendjes faktike në

teren, me ç'rast pozicione të parealizuara në vlerë prej 16,445€, ishin zëvendësuar me pozicione shtesë në vlerë prej 16,393€, pa ndikuar në vlerën totale të kontratës.

Përveç kësaj, është vërejtur se komuna kishte realizuar punime në objekt edhe përmes kontratës kornizë "Mirëmbajtja Teknike e Institucioneve Arsimore", ndonëse kontrata "Ndërtimi i Çerdhes për Fëmijë në Shipol - Faza e Fundit" ishte ende aktive dhe në proces të zbatimit.

Në kuadër të Kontratës së Mirëmbajtjes, më 28.01.2025 ishte pranuar situacioni në vlerë prej 23,890€, i cili përfshinte lyerje, suvatime dhe punime me knauf në Çerdhen e Shipolit, ndërsa pagesa ishte realizuar më vonë përmes procedurave përmbaremore. Sipas sqarimeve të menaxherit të kontratës, lyerja dhe suvatimi nuk përbënin punime të reja, pasi ishin kryer më herët gjatë ndërtimit të objektit. Megjithatë, për shkak se objekti kishte qëndruar për një periudhë të gjatë i papërfunduar dhe jashtë funksionit, ishte paraqitur nevoja për përsëritjen e tyre. Vlen të theksohet se këto punime ishin realizuar nga i njëjti operator ekonomik që ishte pjesë e konsorciumit fitues të kontratës për ndërtimin e çerdhes.

Përveç punimeve të mësipërme, gjatë vitit 2025 komuna kishte lidhur edhe kontrata tjera për funksionalizimin e objektit, përfshirë "Rregullimin e rrjetit elektrik sipas kërkesave të KEDS-it" në vlerë prej 4,490€, "Rregullimin e hapësirave gjelbëruese" në vlerë prej 1,650 €, si dhe "Furnizimin dhe rregullimin e dritareve të çerdhes" në vlerë prej 999€.

Si rrjedhojë, ndonëse kontrata fillestare ishte lidhur në vlerë prej 293,462€, për përfundimin dhe funksionalizimin e objektit komuna kishte realizuar kontrata dhe ndërhyrje shtesë, duke e çuar vlerën totale të investimit në 419,815€. Rrjedhimisht, kostoja e projektit ishte rritur për 126,353€ ose 43% krahasuar me vlerën e kontratës fillestare, dhe për më tepër pretendimi i operatorit ekonomik për pagesë në vlerë prej 351,394€ vazhdon të jetë objekt i procedurave gjyqësore.

Menaxhimi i dobët i projektit, vonesat e operatorit ekonomik, mangësitë në planifikim dhe mungesa e koordinimit efektiv rezultuan në mosfunksionalizimin e objektit, kosto shtesë dhe nevojën për riparimin e punimeve të realizuara më herët.

Ndikimi

Këto mangësi kanë rezultuar në mosfunksionalizimin e objektit dhe si pasojë, në mosfrimin e shërbimeve të planifikuara për përfituesit për një periudhë të gjatë kohore, si dhe në rritje të kostove financiare dhe nevojë për angazhim shtesë të burimeve. Po ashtu, procedura gjyqësore ende e hapur lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik paraqet rrezik për kosto dhe obligime shtesë financiare për komunën.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë që projektet kapitale të planifikohen dhe menaxhohen në mënyrë efektive, duke siguruar hartimin e saktë të paramasave, mbikëqyrjen e duhur të realizimit të kontratave dhe ndërmarrjen me kohë të veprimeve të nevojshme për përfundimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në evidentimin dhe monitorimin e pronave të dhëna në shfrytëzim afatgjatë**Gjetja**

Neni 22 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përcakton se komuna duhet të mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme sipas planit dinamik realizues. Po ashtu, Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtëmujore t'i paraqesë Kuvendit Komunal raportim të veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjen e qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

Gjithashtu, sipas kontratave të lidhura me shfrytëzuesit e pronave komunale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit, obligohen të bëjnë mbikëqyrjen e realizimit të kontratave dhe të hartojnë raporte me shkrim për ecurinë e zbatimit të tyre.

Komuna nuk kishte evidenca të plota për pronat e dhëna në shfrytëzim. Sipas sqarimeve të zyrtarit përgjegjës, evidencat ishin përpiluar vetëm në bazë të të dhënave nga sistemi kadastral, pa u mbështetur në burime të tjera të informacionit. Përveç kësaj, nga 91 prona të evidentuara si të dhëna në shfrytëzim, Sektori i Pronës posedonte kontratat përkatëse vetëm për 14 raste. Gjithashtu, gjatë auditimit kemi identifikuar dy parcela të dhëna në shfrytëzim për KRM "Uniteti" Sh.A., të cilat nuk figuronin në regjistrin e pronave të dhëna në shfrytëzim.

Gjithashtu, komuna nuk na kishte ofruar dëshmi se kishte monitoruar dhe verifikuar përmbushjen e kushteve dhe obligimeve të përcaktuara në kontratat e dhënies në shfrytëzim, përfshirë obligimet financiare (kur ishin të aplikueshme), realizimin e investimeve, numrin e të punësuarve dhe kushtet e tjera kontraktuale.

Mangësitë e tilla ishin si pasojë e moskrijimit të një sistemi të strukturuar për administrimin e pronave të dhëna në shfrytëzim dhe mosfunksionimit të mekanizmave të monitorimit të realizimit të kontratave nga njësitë përgjegjëse.

Ndikimi

Mungesa e evidencave të plota dhe monitorimit të kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, përveç se kufizon mundësinë e komunës për të siguruar menaxhim efektiv të këtyre pronave, ndikon edhe në identifikimin me kohë të mospërmbushjes së obligimeve kontraktuale dhe vlerësimin e arritjes së qëllimit për të cilin pronat janë dhënë në shfrytëzim.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë krijimin dhe mirëmbajtjen e evidencave të plota për pronat e dhëna në shfrytëzim, duke përfshirë dokumentacionin përkatës dhe kushtet kontraktuale. Po ashtu, duhet të sigurojë funksionimin e mekanizmave efektivë për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të kontratave, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së obligimeve kontraktuale dhe arritjes së qëllimeve për të cilat pronat janë dhënë në shfrytëzim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mospërfundimi i projekteve**Gjetja**

Rregullorja Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 prokurim publik neni 70.23 thekson se përgjegjësi e menaxherit të projektit është të menaxhoj obligimet dhe detyrat e AK-së të specifikuara në kontratë dhe të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë, bën vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij. Ndërsa sipas nenit 71A në rast të vonesave për dorëzimin e mallrave, realizimin e shërbimeve apo punëve brenda afateve kohore të specifikuara në kontratë, do të aplikohen penalltitë për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës sipas kontratës dhe datës aktuale të dorëzimit apo realizimit.

Gjatë auditimit kemi identifikuar raste të kontratave të cilat nuk ishin realizuar brenda afateve të përcaktuara si me poshtë:

- Për projektin “Ndërtimi i rrugës Lah Nimani në qytetin e Mitrovicës”, komuna kishte lidhur kontratë më 24.11.2022 në vlerë prej 892,453€, e cila sipas kushteve kontraktuale ishte paraparë të realizohej deri më 24.11.2024. Sipas sqarimeve të menaxherit të kontratës, projekti nuk ishte realizuar brenda afatit për shkak të çështjeve të shpronësimit. Sipas tij, kërkesa e operatorit ekonomik për vazhdimin e afatit nuk ishte aprovuar nga komuna. Pavarësisht kësaj, komuna nuk kishte ndërmarrë masa ndëshkuese kontraktuale, përfshirë aplikimin e penaltive apo konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit. Vlen të theksohet se komuna kishte realizuar pagesa në vlerë prej 674,694€ ose 76% të vlerës së kontratës.
- Për projektin “Ndërtimi i Rrugës Dëshmorët e Kombit në Shipol”, komuna kishte lidhur kontratë më 01.09.2023 në vlerë prej 777,508€, e cila sipas kushteve kontraktuale ishte paraparë të realizohej deri më 31.08.2024. Sipas sqarimeve të menaxherit të kontratës, OE nuk kishte arritur t’i realizonte punimet sipas dinamikës së planifikuar për shkak se ishte i angazhuar edhe në projekte të tjera në Komunën e Mitrovicës . Sipas tij, OE nuk kishte paraqitur kërkesë për vazhdimin e afatit të kontratës. Pavarësisht kësaj, edhe për këtë projekt, komuna nuk kishte ndërmarrë masa ndëshkuese kontraktuale. Vlen të theksohet se komuna kishte realizuar pagesa në vlerë prej 603,357€, ose 78% të vlerës së kontratës.
- Për projektin “Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kollovërt”, komuna kishte lidhur kontratë më 02.09.2025 në vlerë prej 749,776€. Sipas dëshmive përkatëse, pas fillimit të punimeve ishin identifikuar mangësi të konsiderueshme në projektin ekzekutiv, pasi një pjesë e trasesë së rrugës kalonte në prona private për të cilat nuk ishte përfunduar procesi i shpronësimit, ndërsa matjet gjeodezike kishin treguar se një pjesë e projektit shtrihej jashtë territorit administrativ të komunës. Si rezultat, kontrata ishte ndërprerë më 10.10.2025 me marrëveshje të përbashkët ndërmjet palëve. Vlen të theksohet se, më 19.11.2025 komuna kishte paguar 28,555€ për hartimin e projektit ekzekutiv përmes procedurave përmbartimore.
- Për projektin “Furnizim me Kabinete për Shkollë”, komuna kishte lidhur kontratë më 09.12.2024 në vlerë prej 169,979€, e cila sipas kushteve kontraktuale ishte paraparë të realizohej deri më 08.12.2025. Sipas sqarimeve të menaxherit të kontratës, kontrata nuk

ishite realizuar në masën e planifikuar për shkak të mungesës së zotimit të mjeteve financiare. Deri në skadimin e afatit kontraktual ishin realizuar furnizime në vlerë prej 19,824€ ose 12% të vlerës së kontratës, ndërsa furnizime në vlerë prej 150,155€ ose 88% kishin mbetur të përealizuara.

Mangësitë në planifikimin dhe përgatitjen e projekteve, përfshirë moszgjidhjen me kohë të çështjeve pronësore dhe mangësitë në projektet ekzekutive, monitorimi jo i mjaftueshëm i realizimit të kontratave, si dhe mos sigurimi i fondeve të nevojshme, kanë ndikuar që projektet të mos përfundohen brenda afateve kontraktuale. Po ashtu, mosraportimi me kohë i rasteve nga menaxherët e kontratave në zyrën e prokurimit ka ndikuar në mosaplikimin e masave ndëshkuese kontraktuale ndaj operatorëve ekonomikë.

Ndikimi

Mosrealizimi i kontratave brenda afateve të përcaktuara ka kufizuar përfitimin e qytetarëve nga investimet e parapara dhe ka rritur rrezikun e kostove shtesë përmes procedurave të reja të prokurimit. Po ashtu, mosaplikimi i penaltive moskonfiskimi i sigurisë së ekzekutimit, si dhe hartimi i projekteve pa analiza të mirëfillta, kanë rezultuar në humbje financiare për komunën.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë që, para inicimit të procedurave të prokurimit, të adresohen çështjet pronësore, të verifikohet cilësia dhe zbatueshmëria e projekteve ekzekutive, si dhe të sigurohen fondet e nevojshme për realizimin e kontratave. Po ashtu, duhet të forcohet monitorimi i zbatimit të kontratave dhe të sigurohet raportimi me kohë i vonësive dhe pengesave nga menaxherët e kontratave te zyra e prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Dobësi në monitorimin e projektit të subvencionuar

Gjetja

Duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr-04/2017 Mbi kriteret, Standardet dhe procedurat e Financimit të OJQ-ve, Neni 23 Monitorimi dhe raportimi projekteve dhe programeve, pika 1. Për secilën kontratë të lidhur, ofruesi I mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet të kujdeset për monitorimin dhe implementimin e projektit. Ofruesi I mbështetjes financiare mund të themelojë ekip për këtë qëllim.

Komuna më datë 06.11.2024, kishte lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me një konsorcium OJQ-sh për implementimin e projektit “Zhvillimi Rural dhe Agrobiznesi si promotorë të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm”. Vlera totale e projektit ishte 78,000€, prej të cilave Komuna kishte financuar 36,486€, ndërsa pjesa e mbetur ishte financuar nga OJQ-ja. Projekti synonte zhvillimin rural, mbështetjen e agrobizneseve lokale, fuqizimin ekonomik lokal dhe ngritjen e kapaciteteve të përfituesve.

Sipas marrëveshjes, afati për realizimin e projektit ishte një vit nga data e nënshkrimit, ndërsa brenda tre muajve duhej të hartoheshin Plani i Implementimit dhe Plani i Monitorimit. Po ashtu, komuna kishte caktuar një koordinatore të projektit, me përgjegjësi për mbështetjen e realizimit të aktiviteteve, koordinimin me akterët lokalë dhe monitorimin e progresit të projektit.

Pavarësisht kësaj, komuna nuk kishte ofruar dëshmi relevante, si

procesverbale të takimeve koordinuese, raporte monitorimi, evidenca mbi aktivitetet e koordinatorit apo dëshmi se kishte verifikuar aktivitetet dhe rezultatet e raportuara nga OJQ-ja.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mangësive në komunikimin e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara me marrëveshje, si dhe mungesës së koordinimit të brendshëm për zbatimin dhe monitorimin e projektit.

Ndikimi

Mungesa e dëshmive të monitorimit të projekti rrit rrezikun që aktivitetet parapara të mos kenë arritur objektivat dhe rezultatet e synuara nga projekti, duke rritur rrezikun që fondet e investuara të mos kenë prodhuar efektet e pritshme.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë që përgjegjësitë për monitorimin e projekteve të përcaktohen dhe komunikohen qartë, si dhe të dokumentohen aktivitetet monitoruese, në mënyrë që të sigurohet realizimi i aktiviteteve dhe arritja e objektivave të përcaktuara me marrëveshje.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mosfunksionalizimi i pajisjeve mjekësore

Gjetja

Sipas nenit 12 paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, kujdesi shëndetësor zbatohet nëpërmjet masave dhe veprimeve, përfshirë sigurimin e furnizimit me barna, materiale shpenzuese, si dhe pajisje medicinale. Ndërsa sipas nenit 18 paragrafit 2.1, kujdesi parësor shëndetësor përfshin promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin dhe rehabilitimin, që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike, ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen përcakton se komunat janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.

Komuna kishte blerë dy pajisje mjekësore për shërbime diagnostikuese, përkatësisht pajisjen "X-Ray System Digital-Static" dhe pajisjen ortopan, në vlerë totale prej 177,200€, të cilat ishin pranuar më 11.12.2025. Nga ekzaminimi fizik i kryer gjatë auditimit në terren (qershor 2026), kemi konstatuar se këto pajisje ende nuk ishin funksionalizuar dhe nuk ishin vënë në përdorim.

Për më tepër, sipas kushteve të kontratës, periudha e garancionit kishte filluar të rrjedhë nga data e pranimit të pajisjeve.

Mos vënia në përdorim ka ndodhur për shkak të mosplanifikimit dhe moskrijimit me kohë të kushteve infrastrukturore të nevojshme për vendosjen dhe funksionalizimin e pajisjeve diagnostikuese.

Ndikimi

Mungesa e funksionalizimit të pajisjeve ka pamundësuar ofrimin e shërbimeve diagnostikuese për të cilat ato ishin siguruar. Për më tepër, rrjedhja e periudhës së garancionit para vënies së tyre në përdorim zvogëlon mbrojtjen dhe përfitimet që ofron mbulimi garantues.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë planifikim dhe koordinim të duhur të proceseve të furnizimit dhe funksionalizimit të pajisjeve mjekësore, ndërsa për pajisjet e blera të ndërmerren sa më shpejt veprimet e nevojshme për krijimin e

kushteve infrastrukturore dhe teknike për vënien e tyre në përdorim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mos verifikim i pronave komunale

Gjetja	Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parashihet që Komuna çdo vit duhet të kryej veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës. Gjatë auditimit kemi identifikuar se komuna nuk kishte realizuar nivelin e kërkuar të verifikimeve të pronave për vitin 2025. Si rezultat, ndryshimet eventuale në karakteristikat e pronave të tatueshme nuk janë identifikuar dhe reflektuar në mënyrë të plotë në bazën e të dhënave të tatimit në pronë. Mosrealizimi i verifikimit vjetor të pronave në nivelin e kërkuar ligjor ka ardhur si rezultat i kapaciteteve të pamjaftueshme njerëzore dhe mungesës së një qasjeje efektive në planifikimin, organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve të verifikimit në terren.
Ndikimi	Mungesa e verifikimeve të rregullta të pronave mund të rezultojë në mosreflektimin e ndryshimeve faktike në regjistrin e tatimit në pronë, duke cenuar saktësinë e bazës tatimore dhe duke ndikuar negativisht në realizimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë.
Rekomandimi B4	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Vonesat në pagesën e faturave

Gjetja	Sipas nenit 39 të LMFPP-së, përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Gjatë procesit të auditimit janë identifikuar tetë raste të pagesave për mallra dhe shërbime dhe një rast të pagesës nga kategoria e investimeve kapitale, në vlerë të përgjithshme prej 143,667€, të cilat nuk janë realizuar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga pranimi i faturës. Vonesat në pagesë kanë variuar nga 25 deri në 117 ditë pas kalimit të afatit 30 ditor. Vonesat në pagesa kanë ndodhur si rezultat i kontrolleve joadekuate në procesin e realizimit të pagesave, mungesës së fondeve për kontratat e lidhura dhe vonesave në kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm.
Ndikimi	Vonesat në pagesën e faturave, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve, si dhe mund të shkaktojnë kosto shtesë në buxhetin e Komunës në formë të kamatave dhe procedurave përmbartimore.
Rekomandimi B5	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm mbi ekzekutimin e pagesave dhe të sigurojë se të gjitha faturat e vlefshme

paguhen brenda afatit prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2025 ishin në vlerë prej 3,443,793€ apo 95% e të hyrave të planifikuara. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga licencat, të hyrat nga qiraja, shfrytëzimi i hapsirave publike etj.

Çështja A7 - Kontrata të skaduara dhe monitorim jo i mjaftueshëm i pronave të dhëna me qira

Gjetja

Sipas nenit 5 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ndër kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës është që prona e paluajtshme e komunës për dhënien në shfrytëzim të jetë e regjistruar në regjistrat kadastral të pronës. Tutje, sipas nenit 19, paragrafit 5, e drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tretë.

Po ashtu neni 23, paragrafi 1 specifikon që pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës. Derisa, paragrafi 2, i ligjit të njëjtë specifikon se Kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen.

Gjatë auditimit, në procesin e dhënies dhe administrimit të pronave me qira, ne identifikuam mangësitë si në vijim:

- Në regjistrin e qirave për lokale, banesa/shtëpi dhe parcela toke figuronin 167 raste me kontrata të skaduara. Nga këto, tetë raste kishin të bënin me lokale, 152 raste me banesa/shtëpi dhe shtatë raste me parcela toke. Kontratat kishin skaduar në periudhën nga 10.01.2008 deri më 01.04.2025. Për shkak të mosripërtëritjes së tyre, komuna nuk kishte mundur të vazhdonte faturimin e qirasë për shkak të mungesës së bazës kontraktuale. Bazuar në vlerat e përcaktuara në kontratat e skaduara, të hyrat potenciale nga qiraja që do të mund të faturoheshin deri më 31.12.2025, në rast të vazhdimit të kontratave, vlerësohen në 343,509€, prej të cilave 58,990€ do t'i përkisnin vetëm vitit 2025. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2026 komuna kishte filluar procesin e dhënies së kontratave për lokalet komunale.
- Komuna në vitin 2023 kishte hartuar raportin për evidentimin dhe verifikimin e banesave të banimit social. Megjithatë, raporti nuk përmbante rekomandime lidhur me vazhdimin apo ndërprerjen e kontratave për familjet përfituese. Sipas sqarimeve të komunës, për këtë arsye nuk ishin ndërmarrë veprime për ripërtëritjen e kontratave. Pas hartimit të këtij raporti, komuna nuk kishte ofruar dëshmi se kishte kryer monitorime apo verifikime të mëtejshme të këtyre pronave. Si rezultat, nuk kishte siguri nëse banesat vazhdonin të shfrytëzoheshin nga përfituesit fillestarë apo nëse ishin dhënë në shfrytëzim personave të tjerë pa autorizim.

- Tutje, bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të datës 28.06.2024, në një rast, komuna lidhur kontratë për qira për një lokal që nuk kishte qenë në pronësi komunale. Nga aktgjykimi rezulton se komuna e kishte dhënë këtë lokal në vitin 2010 me qira mujore prej 350€, ndërsa çështja gjyqësore lidhur me pronësinë e tij ishte iniciuar më 29.03.2011. Pavarësisht kësaj, faturimi i qirasë kishte vazhduar deri në shkurt 2020. Si rezultat, më 06.05.2025 nga Thesari ishte ekzekutuar një pagesë në vlerë prej 64,825€ në bazë të vendimeve gjyqësore, përfshirë 41,650€ kompensim dëmi, 18,711€ kamatë dhe 4,463€ shpenzime procedurale dhe përmbarimore.

Kjo situatë kishte ardhur si rezultat i mungesës së veprimeve të duhura për trajtimin e kontratave me afat të skaduar, monitorimin e qiramarrësve dhe verifikimin e statusit juridik të pronave të dhëna me qira.

Ndikimi

Mungesa e ndërmarrjes së veprimeve për trajtimin e kontratave të skaduara rrit rrezikun e humbjes së të hyrave nga qiraja dhe shfrytëzimit të paautorizuar të pronave komunale. Gjithashtu, në rast të dëmtimit të pronës nga shfrytëzuesit, mungesa e një marrëdhënieje kontraktuale valide e vështirëson përcaktimin e përgjegjësisë dhe kërkimin e kompensimit të dëmit nga palët përkatëse.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të sigurojë evidentimin e plotë të pronave komunale dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për menaxhimin efektiv të tyre. Po ashtu, duhet të sigurojë raportim të rregullt në Kuvendin Komunal lidhur me statusin, shfrytëzimin dhe menaxhimin e pronave komunale, me qëllim të forcimit të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies në këtë fushë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 16,893,700€ derisa janë shpenzuar 16,822,998€, po thuajse 100% e buxhetit. Numri i pozitive të aprovuara sipas ligjit të buxhetit ishte 1,989 punonjës, ndërsa në fund të vitit numri i të punësuarve ishte 1,864.

Çështja C1 - Mos azhurnimi i kontratave të punës në bazë të ligjit për zyrtarët publik

Gjetja

Sipas nenit 102 pika të Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publik përcaktohet se “Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës”. Po ashtu, Sipas nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, asnjë organizatë buxhetore nuk mund të tejkalojë numrin e të punësuarve në nivel të nënprogramit, në asnjë kohë gjatë vitit fiskal 2025, siç specifikohet në tabelat përkatëse të bashkëngjitura në ligj, përveç lehonave dhe mësimdhënësve në gjendje të rëndë shëndetësore në sistemin e arsimit parauniversitar.

Komuna kishte përditësuar kontratat e punës në sektorin e shëndetësisë dhe administratën komunale, duke i harmonizuar ato me nivelin aktual të pagës bazë dhe koeficientët përkatës. Megjithatë, ky proces ende nuk ishte realizuar në sektorin e arsimit, ku kontratat nuk pasqyronin ndryshimet e ndodhura.

Po ashtu, më 31.12.2025, komuna kishte të angazhuar 11 punonjës më shumë se numri i pozitive të aprovuara me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore. Konkretisht, në arsimin parafillor ishin të angazhuar 63 të punësuar kundrejt 62 pozitive të aprovuara, ndërsa në arsimin fillor 902 të punësuar kundrejt 892 pozitive të aprovuara.

Mosazhurnimi i kontratave ka ardhur si rezultat i vonësve në harmonizimin e tyre me ndryshimet ligjore. Edhe pse Drejtoria e Arsimit kishte filluar procesin e përditësimit të kontratave deri në kohën e auditimit ky proces ende nuk ishte përfunduar. Ndërsa për tejkallimin e evidentuar, komuna nuk ka ofruar sqarime të mjaftueshme për të vlerësuar nëse pozitat shtesë lidhen me raste të përjashtuara nga kufizimet ligjore apo paraqesin tejkallim të limiteve të përcaktuara.

Ndikimi

Mosazhurnimi i kontratave mund të ndikojë në saktësinë e dokumentacionit të personelit, ndërsa tejkallimi i numrit të pozitive të aprovuara mund të vështirësojë kontrollin dhe planifikimin e shpenzimeve për personel.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha kontratat e punës të azhurnohen dhe të harmonizohen me kërkesat e Ligjit për Zyrtarët Publikë. Po ashtu, duhet të sigurojë që numri i të punësuarve të menaxhohet në përputhje me limitet e përcaktuara me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore dhe që angazhimi i stafit të bëhet vetëm brenda numrit të pozitive të aprovuara ose në rastet e lejuara me legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime së bashku me komunalitë ishte 5,737,152€, derisa janë shpenzuar 5,123,020€ apo rreth 89% e buxhetit. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të projekteve, riparimit dhe mirëmbajtjes, blerjen e pajisjeve, shpenzimeve të transportit, etj.

Çështja B6 - Dobësitë në menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja Sipas nenit 70.24 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (Versioni i Konsoliduar), menaxheri i kontratës është përgjegjës për menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratës, si dhe për përgatitjen, mbajtjen dhe arkivimin e të gjitha regjistrave të menaxhimit të kontratës në modulën për menaxhimin e kontratave në sistemin elektronik të prokurimit (e-Prokurimi). Menaxheri i kontratës duhet të sigurojë gjithashtu raportimin mbi progresin dhe përfundimin e kontratës, si dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuale në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës.

Gjatë testimit janë identifikuar 18⁶ raste në të cilat të dhënat lidhur me menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve nuk ishin azhurnuar në modulën përkatëse të sistemit elektronik të prokurimit (e-Prokurimi), siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.

Mos menaxhimi i kontratave përmes sistemit të e-prokurimit ka ndodhur si rezultat i anashkalimit të procedurës së përcaktuar nga rregullorja, për shkak të mungesës së përgjegjësisë administrative nga ana e zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e kontratave.

Ndikimi Mos azhurnimi i menaxhimit të kontratave përmes sistemit elektronik të e-prokurimit nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit të tjerë të lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin e performancës të kontratave.

Rekomandimi B6 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e menaxhimit të kontratave, duke siguruar që të gjitha kontratat të menaxhohen dhe dokumentohen përmes modulit për menaxhimin e kontratës në sistemin e e-prokurimit në pajtim me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Vendosja e kriterëve në dosje të tenderit jo në harmoni të plotë me LPP

Gjetja Sipas nenit 68 të LPP-së, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrijnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do të referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Për aktivitetin e prokurimit “Transporti i nxënësve me mësim të obliguar - Ritender (Lot 4 dhe Lot 6)”, si kriter të përzgjedhjes në dosjen e tenderit, komuna kishte aplikuar edhe kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale duke kërkuar që OE të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy (2) kontrata për shërbime të ngjashme (transport të nxënësve udhëtarë) në tre (3) vitet e fundit. Ne kemi vërejtur se kjo kërkesë nuk ishte aplikuar në harmoni me kërkesat ligjore, pasi që në rastet kur e njëjta aplikohet nga kompania, atëherë duhet të kërkohet vlera e kontratave të realizuara, e cila nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Për më tepër, në këtë aktivitet komisioni i vlerësimit kishte eliminuar një operator ekonomik me arsyetimin se njëra nga dy kontratat e paraqitura si dëshmi e përvojës së ngjashme nuk ishte realizuar brenda periudhës trevjeçare të kërkuar. Megjithatë, sipas kërkesave ligjore, për vlerësimin e përvojës së mëparshme rëndësi ka vlera e kontratave të ngjashme të realizuara gjatë periudhës së përcaktuar, dhe jo numri i kontratave të realizuara. Si rezultat, operatori ekonomik (edhe pse nuk kishte paraqitur ofertën me çmimin më të ulët) ishte eliminuar mbi bazën e një kriteri që nuk ishte përcaktuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së duhur të vëmendjes gjatë vendosjes se kriterëve në dosjen e tenderit.

Ndikimi

Aplikimi i kriterëve në kundërshtim me kërkesat ligjore pamundëson vlerësimin objektiv të ofertave dhe rrit rrezikun që ofertat potencialisht më të favorshme ekonomike të mos merren në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit.

Rekomandimi A8

Kryetari duhet të sigurojë që kriteret e përzgjedhjes në dosjet e tenderit të hartohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik dhe që vlerësimi i operatorëve ekonomikë të kryhet bazuar në kriteret e ligjshme, të qarta dhe të matshme, me qëllim të garantimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe vlerësimit objektiv të ofertave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Investimet kapitale

Buxheti final për Investime Kapitale ishte 8,171,415€, derisa janë shpenzuar 6,909,649€ apo rreth 85% e buxhetit. Ato kryesisht kanë të bëjnë me vendime gjyqësore përmbartimore, ndërtimin dhe rregullimin e infrastrukturës rrugore, ndërtimin e objektit të çerdheve, ndërtimin rregullimin e oborreve të shkollave, blrje te paisjeve mjeksore etj.

Çështja A9 - Moslëshimi i certifikatës së pranimi të përkohshëm pas përfundimit të punëve

Gjetja

Neni 73A.1 (a) i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton se për kontratat për punë për të cilat kërkohet periudha garantuese, menaxheri i Kontratës përgatit dhe nënshkruan Certifikatën e Pranimi të Përkohshëm. Certifikata e Pranimi të Përkohshëm lëshohet jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas pranimi të punëve dhe me lëshimin e saj përmbyllen obligimet e palëve kontraktuese për fazën e ekzekutimit të kontratës.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se për projektet “Ndërtimi i infrastrukturës në oborret e SHFMU-ve Skenderbeu dhe Abdullah Shabani” me vlerë 277,475€, “Ndërtimi i objektit të Bibliotekës së Qytetit Latif Berisha në Mitrovicë” me vlerë 697,121€ dhe “Rregullimi i AMF Fidanishte” me vlerë 6,125€, nuk ishin lëshuar certifikatat e pranimi të përkohshëm, ndonëse projektet ishin përfunduar dhe pagesat ishin realizuar.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosndërmarrjes me kohë të veprimeve të nevojshme nga menaxherët e kontratave për përmbylljen formale të kontratave dhe lëshimin e certifikatave të pranimi të përkohshëm.

Ndikimi

Mungesa e certifikatave të pranimi të përkohshëm rrit rrezikun që mangësitë eventuale në punime të mos identifikohen dhe adresohen brenda periudhës garantuese. Po ashtu, kjo krijon pasiguri lidhur me faktin nëse punimet janë pranuar dhe verifikuar zyrtarisht në përputhje me kushtet dhe specifikimet e kontratës.

Rekomandimi A9

Kryetari duhet të sigurojë që, pas përfundimit të punimeve dhe kryerjes së procedurave të pranimi, menaxherët e kontratave të lëshojnë me kohë certifikatat e pranimi të përkohshëm në përputhje me kërkesat e ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 245,705,129€, pasurive jokapitale është 1,545,760€, si dhe e stoqeve 149,748€. Ku kemi hasur çështje si në vijim:

Çështja A10 - Mos harmonizimi i gjendjes së pasurive me rezultatet e raportit të inventarizimit

Gjetja

Sipas nenit 18, paragrafi 3 të Rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, organizatat buxhetore janë të obliguara që së paku një herë në vit të kryejnë inventarizimin e pasurisë jo financiare, me qëllim të verifikimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të saj, ndërsa neni 19, paragrafi 4.7, përcakton se raporti i inventarizimit duhet të përgatitet në kohë të përshtatshme, përpara përgatitjes së pasqyrave financiare, në mënyrë që të mundësohet reflektimi i saktë i gjendjes së pasurisë. Më tej, sipas nenit 24, paragrafi 1 pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni përcakton se pasuria jo financiare jashtë përdorimit nuk duhet të prezantohet në pasqyrat financiare, por duhet të shpaloset në mënyrë të veçantë.

Gjatë auditimi kemi vërejtur se, komisioni i inventarizimit kishte bërë krahasimin e gjendjes së pasurive vetëm me regjistrimet e vitit paraprak, ndërsa nuk kishte kryer krahasimin e tyre me regjistrat në e-Pasuria dhe SIMFK, si burimet kryesore të evidencës së pasurive.

Përkundër kësaj, komisioni i inventarizimit kishte evidentuar pasuri jashtë përdorimit dhe kishte paraqitur vërejtje të tjera lidhur me gjendjen e pasurive, mirëpo komuna nuk kishte formuar komisionin e vlerësimit për shqyrtimin dhe trajtimin e rezultateve të inventarizimit, siç kërkohet me rregulloren për menaxhimin e pasurisë.

Shkaku i kësaj ka qenë koha e kufizuar në dispozicion për realizimin e procesit të vlerësimit, mangësitë e identifikuar në regjistrat e pasurive që kërkonin verifikime dhe korrigjime shtesë, si dhe mungesa e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin e sistemit e-Pasuria, çka ka ndikuar në mosfinalizimin me kohë të procesit para përpilimit të pasqyrave financiare.

Ndikimi

Mos trajtimi i raportit të komisionit të inventarizimit ka bërë që gjendja reale e pasurive (përfshirë ato të dëmtuara apo jashtë funksionit) të mos harmonizohet me regjistrat, duke rritur rrezikun që vlera e pasurive të mos prezantohet saktë në pasqyra financiare vjetore.

Rekomandimi A10

Kryetari duhet të sigurojë që të bëhet adresimi i çështjeve që identifikohen nga komisioni i inventarizimit dhe të formohet komisioni i vlerësimit në mënyrë që gjendja e pasurive të harmonizohet me regjistrat dhe të reflektohet saktë në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Të arkëtueshmet

Komuna e Mitrovicës së Jugut në PFV-të e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 16,927,266€. Kjo vlerë kryesisht përbëhet prej tatimit në pronë në vlerë 12,206,323€, taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë prej 2,085,252€, taksat dhe tarifat e urbanizmit prej 462,892€, pagesave për mbeturina për ekonomi familjare 2,150,063€, etj. Gjatë vitit 2025, llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë janë rritur për 1,611,721€ ose 15% krahasuar me vitin 2024.

Çështja B7 - Mangësi në inkasimin dhe menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Neni 26 dhe 27 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme përcaktojnë se komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritet për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, ndërsa komuna, në rast të mospagesës brenda afateve të përcaktuara, është e obliguar të ndërmarrë veprimet e parapara ligjore për inkasimin e tyre. Po ashtu, sipas 16 të Rregullores së Ministrisë së Financave nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të obliguara të mbajnë regjistra për të hyrat e mbledhura dhe shumat e faturuara e të paarkëtuara, si dhe t'i shpalosin llogaritë e arkëtueshme në raportin vjetor financiar sipas llojit të të hyrave, ndërsa sipas nenit 22 të Rregullores nr. 02/2019 për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale të Komunës së Mitrovicës së Jugut, për personat fizikë dhe juridikë që nuk i përmbushin obligimet për pagesën e taksave dhe tarifave komunale, parashihet ndërmarrja e procedurave të ekzekutimit përmes gjykatave kompetente ose përmbareseve privatë, në rastet e lejuara me ligj.

Gjatë vitit 2025, vlera totale e llogarive të arkëtueshme të komunës ishte 16,927,266€, duke paraqitur rritje prej 698,225€ krahasuar me vitin paraprak (16,229,041€). Popullacioni i llogarive të arkëtueshme përbëhej kryesisht nga tatimi në pronë në vlerë prej 12,206,323€ (72%), tarifat për mbeturina për ekonomitë familjare në vlerë prej 2,150,063€ (13%) dhe tarifat për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në vlerë prej 2,085,252€ (12%), ndërsa pjesa tjetër përbëhej nga kategori të tjera të llogarive të arkëtueshme me vlera më të ulëta. Pavarësisht nivelit të lartë dhe rritjes së vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme, komuna nuk kishte ndërmarrë veprime të mjaftueshme për inkasimin e tyre.

Sa i përket llogarive të arkëtueshme nga tarifa e mbeturinave për ekonomitë familjare, në vlerë prej 2,150,063€, ato i përkisnin periudhës 2017-2022, kur faturimi dhe inkasimi i kësaj tarife administrohej nga komuna. Sipas sqarimeve të komunës, nga 01.07.2022 faturimi dhe inkasimi i tarifave rrjedhëse ishte bartur te KRM Uniteti, ndërsa borxhet e krijuara deri në atë datë kishin mbetur si llogari të arkëtueshme të komunës. Megjithatë, për këto detyrime nuk ishin ndërmarrë masa sistematike për inkasimin e tyre, për pasojë vlera e tyre kishte mbetur pothuajse e pandryshuar ndër vite.

Tutje, lidhur me llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë, bazuar në konfirmimet e komunës dhe dëshmitë e auditimit, kemi identifikuar mangësi në administrimin e regjistrit të llogarive të arkëtueshme, të cilat ishin reflektuar në mosregjistrimin saktë të pagesave të realizuara dhe mospërputhje ndërmjet të dhënave të sistemit dhe dokumentacionit

mbështetës.

Po ashtu, gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme në kategori të tjera, kemi identifikuar se në raport ishte përfshirë një vlerë prej 13,197€ për ndërrimin e kulturës bujqësore, ndonëse fatura ishte anuluar për shkak të pezullimit të procedurës administrative. Ndërsa, në dy raste të llogarive të arkëtueshme nga qiraja kemi identifikuar nënvlerësim prej 16,999€, për shkak të mungesës së evidencave në kartelat individuale financiare që nga viti 2019.

Mangësitë e identifikuara kishin ardhur si rezultat i mosndërmarrjes së veprimeve të mjaftueshme për inkasimin e llogarive të arkëtueshme, mungesës së kontrolleve dhe verifikimeve të rregullta të evidencave dhe raporteve financiare, si dhe problemeve të vazhdueshme në funksionimin e sistemit të tatimit në pronë, të cilat kishin ndikuar në paraqitjen jo të saktë të detyrimeve të tatimpaguesve.

Ndikimi

Mosinkasimi i borxheve të akumuluar ndikon drejtpërdrejt në uljen e nivelit të të hyrave vetanake, duke kufizuar kapacitetin financiar të komunës për realizimin e objektivave të saj zhvillimore, ndërsa mangësitë në administrimin e llogarive të arkëtueshme rrisin rrezikun e paraqitjes jo të saktë të tyre në PFV.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë verifikimin dhe harmonizimin e rregullt të evidencave të llogarive të arkëtueshme, ndërmarrjen në kohë të veprimeve ligjore për mbledhjen e detyrimeve të papaguara, si dhe, në koordinim me institucionet qendrore përgjegjëse, adresimin e mangësive të identifikuara në sistemin e tatimit në pronë, me qëllim të sigurimit të evidencave të sakta dhe të besueshme për të gjitha kategoritë e llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1

Korrigjimi i pasqyrave financiare vjetore

Gjetja

Gjatë auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), janë identifikuar disa mospërputhje në prezantimin dhe shpalosjen e informacionit financiar, si në vijim:

1. Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit

- Në kolonën e realizimit, tek hyrja e parasë së gatshme (Shënim 12), është prezantuar vlera prej 543,000€, e cila përfaqëson të hyra nga gjobat e trafikut, gjykatat dhe nga Agjencioni Pyjor i Kosovës. Këto të hyra nuk duhet të përfshihen në totalin e të hyrave si të hyra të realizuara nga komuna tek kjo pjesë, por vetëm duhet të shpalosen në PVF.
- Në kuadër të rishikimit të PVF-së dhe krahasimit të tyre me shënimet e Thesarit, kemi vërejtur se në shënimet shpjeguese nuk është përfshirë vlera prej 31,320€, e cila sipas Thesarit figuron në kodin ekonomik 83140 - Të hyrat për Fondin në Mirëbesim (depozita për shpronësime). Kjo vlerë duhet të përfshihet në Shënimin 12 - Të hyrat tjera (neni 14) dhe të shpaloset në mënyrë të qartë në shënimin përkatës.
- Në shënimet shpjeguese të Shënit 11 - Grantet e përcaktuara të donatorëve, është shpalosur vlera prej 338,000€, duke përfshirë edhe donacionet e bartura nga vitet paraprake në vlerë prej 92,000€. Në këtë shënim duhet të shpalosen vetëm donacionet e pranuar gjatë vitit aktual, në përputhje me vlerën e prezantuar në nenin 14, në shumën prej 246,000€.

Veprimi i kërkuar

Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për t'i korrigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Rezultati

Menaxhmenti kishte marrë veprime korrigjuese për paraqitje të drejtë dhe të saktë të PFV gjatë procesit të auditimit dhe kishte bërë korrigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PVF e vitit vijues atëherë çështja do të rezultojë me rekomandim në raportin e auditimit.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	30,240,512	32,200,785	30,093,608	28,939,149	26,800,882
Grante Qeveritare - Buxheti	26,625,017	27,379,370	26,311,758	25,409,606	22,142,266
Të bartura nga viti i kaluar	0	867,555	716,926	1,066,226	1,345,468
Të hyrat vetanake	3,615,495	3,615,495	2,906,773	2,431,929	2,897,727
Donacionet vendore	0	72,211	0	21,943	29,237
Donacionet e jashtme	0	266,153	158,150	9,446	386,186

Buxheti final i Komunës së Mitrovicës së Jugut është më i lartë se buxheti fillestar për 1,960,273€ apo 6%. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 754,354€, përfshirjes së të hyrave të bartura nga vitet paraprak në vlerë prej 867,555€ dhe donacioneve në vlerë prej 338,364€ në buxhet final.

Në vitin 2025, komuna ka shpenzuar rreth 93% të buxhetit final ose 30,093,608€, me një rritje prej 4% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Vlen të theksohet se Thesari nga kategori të ndryshme ekonomike sipas vendimeve përmbartimore/gjyqësore kishte realizuar pagesa në vlerë 3,568,937€, për obligime të dala nga kontrata kolektive dhe për operatorë ekonomik.

Komuna kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	30,240,512	32,200,785	30,093,608	28,939,149	26,800,882
Pagat dhe mëditjet	16,121,015	16,893,700	16,822,998	17,487,299	14,583,138
Mallrat dhe shërbimet	4,820,000	5,137,152	4,584,708	3,824,127	3,894,431
Komunalitë	600,000	600,000	538,312	423,502	487,812
Subvencionet dhe transferet	1,209,150	1,398,518	1,237,941	1,403,498	2,004,864
Investimet Kapitale	7,490,347	8,171,415	6,909,649	5,800,723	5,830,637

Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 722,685€. Buxheti final përbëhet nga granti qeveritar në vlerë prej 16,802,368€, pastaj nga të hyrat vetanake prej 73,000€, të hyrave vetanake të bartura prej 5,000€ dhe donacionet e jashtme prej 13,332€. Për përudhen janar - dhjetor 2025 realizimi i buxhetit është 16,822,998€ apo 99.5% e buxhetit final;


- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 317,152€. Pjesa më e madhe e këtij buxheti përbëhet nga granti qeveritar prej 3,751,664€, të hyrave vetanake prej 1,068,336€, të hyrave vetanake të bartura prej 295,000€ dhe donacionet në vlerë prej 22,152€. Deri në fund të vitit 2025 realizimi i buxhetit ishte 4,584,708€ apo 89% e buxhetit final;

- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Ky buxhet përbëhet nga granti qeveritar në vlerë prej 600,000€. Deri në fund të vitit realizimi i buxhetit ishte 538,312€ apo 90% e buxhetit final;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 189,368€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 24,991€, të hyrave vetanake prej 1,184,159€, të hyrave vetanake të bartura prej 159,595€ dhe grantit të donacioneve të brendshme prej 29,773€. Realizimi i buxhetit në fund të vitit ishte 1,237,941€ apo 87% e buxhetit final; dhe

- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje në vlerë prej 681,068€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 6,200,347€, të hyrave vetanake prej 1,290,000€, të hyrave vetanake të bartura 407,960€ dhe donacioneve prej 273,107€. Deri në fund të vitit komuna kishte arritur të shpenzoj vetëm 6,909,649€ apo 85% e buxhetit. Vlen të theksohet se vlera prej 3,225,956€ është ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore për kontratë kolektive, paga jubilarë dhe operatorë ekonomik nga kategoria e investimeve kapitale.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Mitrovicës së Jugut në vitin 2025 ishin në vlerë prej 3,443,793€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga rone në rone, taksat për leje ndërtimi, participimet, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike, etj. Për vitin 2025, komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 3,615,495€. Në krahasim me vitin e kaluar, niveli i inkasimit të të hyrave ka shënuar rritje prej 738,803€ apo rreth 27%.

Përveç kësaj, të hyrat nga gjambat në trafik dhe gjambat nga gjykatat ishin në shumë prej 543,956€, të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), dhe më pas alokohen për komunën për shpenzim. Këto të hyra nuk janë përfshirë në tabelën e mëposhtme, për arsye se planifikohen dhe realizohen nga ministritë përkatëse.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	3,615,495	3,615,495	3,443,793	2,704,990	3,698,351
Të hyrat tatimore	1,112,882	1,112,882	1,224,847	1,174,381	1,567,884
Të hyrat jo tatimore	2,502,613	2,502,613	2,217,616	1,527,109	2,129,999
Të hyrat tjera	0	0	1,330	3,500	468

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të vitit 2024 ka rezultuar me gjithsej 13 rekomandime. Komuna e Mitrovicës kishte hartuar një Plan Veprimi, në të cilin janë përcaktuar masat dhe veprimet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, katër rekomandime ishin zbatuar, shtatë nuk janë zbatuar ende, një rekomandim ishte zbatuar pjesërisht, dhe një nuk ishte i aplikueshëm më siç është paraqitur në Grafikon 1, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 1 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Keqklasifikimet - Investimet dhe Vendimet Gjyqesore	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në bashkëpunim me MF-në që të gjitha pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.	Nuk është adresuar, pasi janë identifikuar përsëri raste të keqklasifikimit të shpenzimeve gjatë vitit 2025	Nuk është adresuar

2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që të rishikojë tërësisht regjistrin kontabël të pasurive dhe të bëjë korrigjimet e nevojshme për rastet e mbivlerësimit dhe nënvlerësimit, të sigurojë që pasuritë e përfunduara të klasifikohen si pasuri në përdorim dhe t'u aplikohet zhvlerësimi sipas rregullave përkatëse.	Rekomandimi nuk është zbatuar, pasi gjatë auditimit janë identifikuar ende gabime dhe pasaktësi në regjistrin e detyrimeve kontigjente, duke treguar se kontrollet e vendosura nuk kanë siguruar evidencim të saktë dhe të përditësuar të këtyre detyrimeve.	Nuk është adresuar
3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së PFV-ve detyrimet kontingjente të shqyrtohen me kujdes, të vlerësohen në përputhje me dokumentacionin mbështetës dhe të raportohen me vlera të sakta.	Detyrimet kontingjente nuk janë harmonizuar plotësisht me gjendjen reale të rasteve gjyqësore, për pasojë edhe gjatë vitit 2025 janë identifikuar pasaktësi në raportimin e tyre, duke treguar se rekomandimi mbetet i pazbatuar.	Nuk është adresuar
4.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në harmonizimin e evidencave të brendshme me të dhënat e raportuara, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme dhe raportimit të saktë dhe të plotë të tyre në PFV.	Kjo çështje nuk është më e aplikueshme si gjetje e veçantë, pasi është trajtuar në kuadër të çështjes Pasaktësi në llogaritë e arkëtueshme dhe mosndërmarrja e veprimeve për arkëtimin e borxheve	Nuk është i aplikueshëm më

5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që komisionet e vlerësimit të ofertave të verifikojnë plotësisht dhe në mënyrë të dokumentuar përmbushjen e të gjitha kriterëve kualifikuese, në përputhje me dokumentet e tenderit. Po ashtu, është e nevojshme të forcohen kontrollet e brendshme dhe mbikëqyrja gjatë fazës së vlerësimit, për të shmangur përzgjedhjen e operatorëve që nuk përmbushin kriteret ligjore në dosje të tenderit.	Rekomandimi konsiderohet i zbatuar. Gjatë testimit të procedurave të përzgjedhura të prokurimit nuk kemi vërejtur raste të operatorëve ekonomikë të shpërblyer pa i përmbushur kriteret kualifikuese të përcaktuara në dosjet e tenderit. Dokumentacioni i testuar dëshmon se komisionet e vlerësimit kanë kryer verifikimin e kriterëve në përputhje me kërkesat e tenderit.	I zbatuar
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Verifikimi i gjendjes aktuale të pronave komunale nuk është kryer as gjatë vitit 2025, prandaj kjo çështje vazhdon të mbetet e pa adresuar.	Nuk është adresuar
7.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar rekrutimin e rregullt për pozitat që aktualisht mbulohen me ushtrues detyre, në mënyrë që të respektohen afatet ligjore.	Rekomandimi konsiderohet i zbatuar, pasi gjatë vitit 2025 nuk kemi identifikuar raste të tejkalimit të afateve ligjore për pozitat e mbuluara me ushtrues detyre. Kjo edhe si rezultat i ndryshimeve ligjore të bëra me Ligjin Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin është rritur afati maksimal i	I zbatuar

			ushtrimit të detyrës në 12 muaj, me mundësi vazhdimi në kushte të caktuara, ndërsa periudha maksimale e mbulimit të pozitës me ushtrues detyre është përcaktuar deri në dy vite. Po ashtu, ligji ka sqaruar se afatet e reja fillojnë të llogariten nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore, përkatësisht nga data 17.06.2025, dhe periudhat paraprake të ushtrimit të detyrës sipas ligjit bazik nuk llogariten në këto afate. Si rezultat, rastet e trajtuara gjatë auditimit nuk paraqesin tejkalim të kufijve të përcaktuar me legjislacionin aktual në fuqi.	
8.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontratat e punës/stafit azhurnohen dhe janë në përputhje me kërkesat e Ligjit për Zyrtarët Publik.	Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar. Gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë veprime për harmonizimin dhe azhurnimin e kontratave të punës në përputhje me kërkesat e Ligjit për Zyrtarët Publik, mirëpo kontratat e stafit në sektorin e arsimit ende nuk janë azhurnuar sipas dispozitave të legjislacionit aktual në fuqi.	Pjesërisht i zbatuar

9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm mbi ekzekutimin e pagesave dhe të sigurojë se të gjitha faturat e vlefshme paguhen brenda afatit prej 30 ditësh.	Edhe gjatë vitit 2025 janë evidentuar raste të vonesave në pagesën e faturave, çka tregon se veprimet e ndërmarra nuk kanë qenë të mjaftueshme për adresimin e rekomandimit.	Nuk është adresuar
----	--------------------------------------	---	--	--------------------

10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, të bëhet një vlerësim i saktë i nevojave reale të komunës gjatë përgatitjes së kërkesave për tender dhe peshët e specifikuara në dosjet e tenderit të reflektojnë rëndësinë dhe vëllimin e pritshëm të shërbimeve që do të kryhen në praktikë. Gjatë zbatimit të kontratës, menaxherët e kontratave të monitorojnë zbatimin sipas peshëve të miratuara, për të garantuar përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe objektivat buxhetore.	Gjatë vitit 2025, nga testimi i rasteve të përzgjedhura nuk kemi vërejtur tejkalime të pozicioneve, kategorive të peshuara apo vlerës së kontratave. Përveç monitorimit nga menaxheret e kontratave përkatëse, kjo është ndikuar edhe nga funksionimi i kontrolleve të brendshme gjatë procesit të certifikimit të pagesave. Në këtë aspekt, zyrtari certifikues ka mbajtur evidenca të detajuara për secilën kontratë në tabela përcjellëse në Excel, duke rishikuar çdo pagesë dhe realizim pozicion për pozicion. Përmes këtij monitorimi të vazhdueshëm është mundësuar identifikimi me kohë i çdo rreziku potencial për tejkalim, çka paraqet një kontroll kyç dhe praktikë të mirë në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratave.	I zbatuar
-----	--------------------------------------	--	--	-----------

11.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e menaxhimit të kontratave, duke siguruar që të gjitha kontratat të menaxhohen dhe dokumentohen përmes modulit për menaxhimin e kontratës në sistemin e e-prokurimit në pajtim me kërkesat ligjore.	Edhe gjatë vitit 2025 janë identifikuar raste të mosmenaxhimit të kontratave në përputhje me kërkesat e platformës elektronike të e-prokurimit, duke treguar se rekomandimi mbetet i pazbatuar.	Nuk është adresuar
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të ndërmarrë masa konkrete për zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë mbledhjen e të hyrave, përfshirë iniciimin e procedurave përmbartimore ndaj debitorëve në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në legjislacion.	Pasaktësitë në llogaritë e arkëtueshme vazhdojnë të jenë të pranishme, ndërsa nuk janë ndërmarrë veprime të mjaftueshme për trajtimin e borxheve të papaguara, për pasojë çështja mbetet e paadresuar.	Nuk është adresuar
13.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha drejtoritë përkatëse të përgatisin dhe të dorëzojnë plane konkrete veprimi për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së. Në të njëjtën kohë, NjAB duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një procedurë të qartë dhe të dokumentuar për ndjekjen dhe raportimin e progresit të zbatimit të rekomandimeve, duke u bazuar në informata të sakta dhe të verifikueshme.	Rekomandimi konsiderohet i zbatuar, pasi menaxhmenti ka hartuar Planin e Veprimit për implementimin e rekomandimeve dhe ka ndërmarrë aktivitete konkrete për adresimin e tyre. Përmes këtij plani janë përcaktuar përgjegjësit institucionale, afatet kohore dhe veprimet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Shpresa Zenelaj, Udhëheqëse e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Kaltrina Neziri, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leterkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA VOJVOĐINA			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: 22.06.2026			
Klasifikim dhe Kod			
04	47	1113	1



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA VOJVOĐINA	
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT	
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE	
Nr. Prot. 01.420/25-0035919/26	
Data: 23.06.2026	
Adresa: Mitrovica - Mitrovica	

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Jugut, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025;
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Faton PEÇI

Kryetari i Komunës

Data: 22.06.2026, Mitrovicë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Projekti “Rregullimi i shtratit të lumit Ibër” në vlerë prej 737,076€, për të cilin ishte lëshuar Certifikata e Pranimit të Përkohshëm më 12.02.2025. Zhvlerësimi që do të duhej të llogaritej deri më 31.12.2025 ishte 15,356€; Projekti “Ndertimi i Biblotekes Latif Berisha” në vlerë prej 697,121€, për të cilin, sipas dokumentacionit të ofruar nga menaxheri i kontratës, punimet ishin realizuar më 21.05.2025. Zhvlerësimi që do të duhej të llogaritej deri më 31.12.2025 ishte 10,166€; Projekti “Rregullimi i objekteve shëndetësore” në vlerë prej 110,232€, për të cilin punimet ishin përfunduar më 24.12.2024. Zhvlerësimi që do të duhej të llogaritej për vitin 2025 ishte 2,756€
- ⁶ 1. Ndërtimi i rrugës në lagjen Shipol 2. Ndërtimi i rrugëve në fshatin Zhabar 3. Rregullimi i objektit të SHFMU “Migjeni” - Iliridë 4. Ndërtimi i infrastrukturës në oborret e shkollave fillore dhe të mesme (SHFMU “Skënderbeu” dhe SHFMU “Abdullah Shabani”) 5. Ndërtimi i rrugëve në fshatin Koprivë - bashkëfinancim nga DEMOS 6. Ndërtimi i rrugëve në lagjen Bair 7. Asfaltimi, riparimi dhe rregullimi i rrugëve në qytet dhe fshatra 8. Ndërtimi i Bibliotekës së Qytetit “Latif Berisha” në Mitrovicë 9. Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Mitrovicë 10. Loti I - Ndërtimi, asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve në Melenicë, Stan Tërg, degëzimin e magjistrales, Rr. “Kopshti” dhe degëzimin e Rr. “Kuvendi i Lezhës” 11. Rregullimi i AMF Fidanishte 12. Furnizim me ushqim dhe pije (shujta, jo dreka zyrtare) për NJPZSH - Mitrovicë 13. Furnizim me barna dhe material tjetër shëndetësor 14. Furnizim me pajisje sportive, dyer dhe dritare, inventar shkollor, materiale dhe pajisje të tjera për institucionet arsimore 15. Furnizim me material administrativ dhe shtypës (dokumente blanko) për QKMF-në, QMF-të dhe AMF-të 16. Furnizim me material administrativ shkollor dhe pedagogjik 2025-2024 17. Furnizim dhe montimi i serrave të tipit tunel me sip. 50m² me material përcjellës për fermerët përfitues 18. Organizimi i panairëve “Konaku i Mitrovicës” dhe Panairi i Fundvitit.
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.